

**VENDIM**  
**Nr. 450, datë 29.6.2022**

**PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE TË PËRMBAJTJES SË LEJEVE TË**  
**QËNDRIMIT PËR TË HUAJT<sup>1</sup>**

*(Ndryshuar me vendimin nr. 215, datë 1.4.2026)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e formës dhe të përmbajtjes së lejeve të qëndrimit për të huajt, sipas anekseve 1 e 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

*1/1. Miratimin e formës së kartëqëndrimit të një anëtari të familjes së një shtetasi të Bashkimit Evropian, sipas aneksit nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.*

2. Për të huajt, që me marrëveshje qeveritare është parashikuar një format standard i aprovimit për qëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë, zbatohet formati i parashikuar në marrëveshjen qeveritare.

3. Vendimi nr. 441, datë 15.6.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formës dhe të përmbajtjes së lejes së qëndrimit për të huajt”, shfuqizohet.

4. Në datën e aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, pika 1, e këtij vendimi, dhe anekset 1 e 2, bashkëlidhur vendimit si pjesë përbërëse të tij, shfuqizohen.

5. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Arben Ahmetaj**

---

<sup>1</sup> Ky vendim është përafuar pjesërisht me:

- rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1030/2002, e datës 13 qershor 2002, e ndryshuar, që përcakton një format uniform për lejet e qëndrimit për shtetasit e vendeve të treta. Numri CELEX 32002R1030, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 157, datë 15.6.2002, faqe 1–7;

- rregulloren e Këshillit (KE) nr.380/2008, e datës 18 prill 2008, që ndryshon rregulloren (KE) nr. 1030/2002, që përcakton një format uniform për lejet e qëndrimit për shtetasit e vendeve të treta. Numri CELEX 32008R0380, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 115, datë 29.4.2008, faqe 1–7;

- rregulloren (BE) 2017/1954, e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e datës 25 tetor 2017, që ndryshon rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1030/2002, që përcakton një format uniform për lejet e qëndrimit për shtetasit e vendeve të treta. Numri CELEX 32017R1954, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 286, datë 1.11.2017, faqe 9–14.

## ANEKS 1

### ELEMENTET E SIGURISË SË LEJEVE TË QËNDRIMIT PËR TË HUAJT

#### I. PËRSHKRIMI I KARTËS

Lejet e qëndrimit për të huajt, duke përfshirë të dhënat biometrike të mbajtësit, prodhohen si një kartë “*smart*” hibride, me dy *chip*-e të ndryshme: me kontakt dhe pa kontakt.

Përmbajtja elektronike e *chip*-eve përfshin këto aplikime:

- *chip*-i me kontakt (*contact chip*);
- aplikimi Java;
- aplikimi ID;
- aplikimi PKI;
- aplikimi Krahësim në Kartë;
- *chip*-i pa kontakt (*contactless chip*);
- aplikimi ICAO.

#### II. ELEMENTET E SIGURISË SË KARTËS

##### 1. Materiali

Materiali i Kartës, në përputhje me standardet ICAO 9303 dhe me specifikimet teknike të ISO 7810, plotëson minimalisht këto kërkesa:

- *polycarbonate*;
- jetëgjatësi *max.* 10 vjet;
- trupi i kartës të jetë UV Dull.

##### 2. Teknika të printimit

Gjatë procesit të printimit aplikohen këto teknika:

- *OVI Printing*;
- *Microtext*;
- *Kinegram*;
- *Line Structures*;
- *GUILLOCHES*.

Të gjitha elementet e sigurisë, që përdoren në printimin e kartës në zona të caktuara, kanë një pamje uniforme.

##### 3. Mbrojtja kundër kopjimit

Një element OVD (*kinegrame*) aplikohet në faqen e parme të kartës, duke u trupëzuar në strukturën e saj, duke na dhënë kështu një nivel të lartë sigurie kundër kopjimit.

##### 4. Teknika e personalizimit

Për t’u siguruar që të dhënat e personalizuara në kartën e lejes së qëndrimit janë të sigurt kundër orvatjeve për ta falsifikuar, të dhënat biografike, përfshirë dhe fotografinë e mbajtësit, si dhe të dhënat e tjera të lejeve të qëndrimit, integrohen më tej në materialin bazë të kartës, nëpërmjet procesit të personalizimit (lëshimit). Teknika që përdoret për këtë qëllim është “*laser engraving*”.

## ANEKS 2

### FORMA DHE MODELI I LEJEVE TË QËNDRIMIT PËR TË HUAJT

#### I. TRUPI I LEJEVE TË QËNDRIMIT

Leja e qëndrimit në formatin D1 përbëhet nga shtresa të ndryshme prej materiali *policarbonat*. Procesi i laminimit e bën trupin e kartës njësh e të pandashëm.

Dimensionet e lejes së qëndrimit janë në përputhje me specifikimet teknike të standardit ISO 7810, me dimensione, si vijon:

- Gjerësi:  
min. 85.47 mm;  
max. 85.72 mm;
- Lartësi:  
min. 53.93 mm;  
max. 54.04 mm;
- Të katër qoshet të harkuara me rreze:  
 $r = 2.88$ ;  
 $r = 3.48$  mm (ISO 7813).

## II. PËRMBAJTJA E LEJEVE TË QËNDRIMIT

Trupi i lejeve të qëndrimit është i përbërë nga material *policarbonat* dhe pamja e dy faqeve është si në fig. 1 dhe fig. 2.

Të gjitha të dhënat si: portreti (1), nënshkrimi (2), imazhi *ghost* (3) dhe të dhënat alfanumerike (4) printohen me teknologji “*laser engraving*”.

Informacioni (6) - Titulli i dokumentit në shqip dhe në anglisht:

### LEJE QËNDRIMI RESIDENCE PERMIT

Informacioni (7) - Kodi në 1–3 shkronja, që përfaqëson tipin e lejes së qëndrimit sipas motivit:

A, B, C, UNB, CBB, CBC.

Informacioni (8) – Numri personal për shtetasit e huaj (FID).

Në faqen e prapme të lejes së qëndrimit printohet shiriti MRZ (në format 3 rreshta) sipas standardeve ICAO (5).





Fig. 1: Faqja e përparme

Fig. 2: Faqja e prapme



ANEKS NR. 3  
KARTË QËNDRIMI PËR ANËTARIN E FAMILJES SË SHTETASIT TË BASHKIMIT  
EVROPIAN

*(Shtuar me vendimin nr. 215, datë 1.4.2026)*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDASHME  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT  
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN  
Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin \_\_\_\_\_

KARTË QËNDRIMI PËR ANËTARIN E FAMILJES SË SHTETASIT TË BASHKIMIT  
EVROPIAN

RESIDENCE CARD FOR FAMILY MEMBER OF A EUROPEAN UNION CITIZEN

Seria dhe Numri i Kartës

Series and Card Number

BG 239200

EMRI (AT), MBIEMRI \_\_\_\_\_

First name (s), Family name

VENDLINDJA \_\_\_\_\_

Place of birth

DATËLINDJA dd.mm.yy

Date of birth

SHTETËSIA \_\_\_\_\_

Nationality

GJINIA \_\_\_\_\_

Sex

Foto  
Photograph

NUMRI I PASAPORTËS/DOKUMENT IDENTIFIKIMI \_\_\_\_\_

Passport Number/ Identification document

ADRESA E VENDBANIMIT \_\_\_\_\_

Residential Address

FID NUMBER \_\_\_\_\_

Foreigner identification number

Kjo kartë qëndrimi, është e vlefshme nga data dd.mm.yy deri më dd.mm.yy

This Residence Card is valid from \_\_\_\_ until \_\_\_\_.

DREJTORI I DVKM

Director

Nënshkrimi, Vula e Autoritetit

